

VENDIM
Nr.990, datë 11.6.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.524, DATË 30.7.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE MËNYRËN E KOMPENSIMIT TË QIRASË SË
BANESËS DHE TË USHQIMIT TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21 të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.524, datë 30.7.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 3, fjalët “...sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1975 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,...” zëvendësohen me “...sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,...”.

b) Në pikën 4, fjalët “...sipas normës nr.4, të përcaktuar në vendimin nr.160, datë 9.7.1975 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar,...” zëvendësohen me “...sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet vendimit nr.88, datë 28.1.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të efektivave ushtarake të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,...”.

2. Efektet financiare, prej 95 000 000 (nëntëdhjetë e pesë milionë) lekësh, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 17.2.2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha